

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8577, DATË 10.02.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Hartimi i këtij projektligji është diktuar nga nevoja për të bërë të mundur, që Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i zgjedhur sipas nenit 125 të Kushtetutës, të fillojë ushtrimin e detyrës të tij edhe në rastin, kur bërja e betimit përpara Presidentit të Republikës është e pamundur. Synimi i këtyre shtesave në ligj, është ofrimi i një mekanizmi efektiv, për të mos penguar në të ardhmen, punën e Gjykatës Kushtetuese duke siguruar që betimi të bëhet brenda një kohe të mjaftueshme, pa cënuar fillimin e ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

II. VLERËSIM I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.

Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat madhorë të qeverisë shqiptare, për të vijuar me reformimin e sistemit të drejtësisë dhe krijimin sa më parë të Gjykatës Kushtetuese.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Projektligji mundëson zgjidhjen e situatës aktuale të krijuar në vend, e cila ka bërë të pamundur fillimin e punës së Gjykatës Kushtetuese. Ky projektligj i jep mundësinë Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, që betimin e parashikuar në nenin

129 të Kushtetutës ta paraqesë/dërgojë në formë të shkruar pranë Presidentit të Republikës. Neni 129 i Kushtetutës e shikon personin e zgjedhur sipas nenit 125 të saj si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkon vetëm, që ai të kryejë betimin para Presidentit, përpara fillimit të ushtrimit të detyrës. Nisur edhe nga parashikimi i nenit 124 të Kushtetutës, sipas të cilit kjo gjykatë i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, asnjëri nga institucionet e tjerë shtetërore nuk duhet të ketë mundësinë, që të bllokojë fillimin e ushtrimit të detyrës nga një Gjyqtar i kësaj gjykate.

Propozimet e përcjella përmes këtij projektligji janë në përputhje me vlerësimin e Komisionit të Venecias, i cili në opinionin e tij të datës 22 Qershor 2006, nr. i dokumentit CDL-AD (2006)016-e, ka trajtuar një rast të ngjashëm me Gjykatën Kushtetuese së Ukrainës, ku ndër të tjera është shprehur, që procedura e betimit nuk duhet të çojë në dhunimin e të drejtës së Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të ushtruar detyrën e tij. Zgjidhjet e formuluar me shtesat e propozuara sipas këtij projektligji, synojnë të ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për situatën e krijuar, nëpërmjet paraqitjes së betimit në formë të shkruar te Presidenti i Republikës. Për këtë qëllim, është përcaktuar afati i qartë për organizimin e ceremonisë së betimit. Kur Presidenti i Republikës nuk organizon ceremoninë e betimit, brenda afatit, anëtari i Gjykatës Kushtetuese, kryen betimin në formë të shkruar. Betimi me shkrim i përcillet Presidentit të Republikës, Gjykatës Kushtetuese dhe organit të emërtesës. Gjithashtu nëpërmjet projektligjit është përcaktuar qartë se cila është data e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, e cila përfshihet në dosjen e tij personale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me parimet kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi, duke siguruar respektimin e dinjitetit të personave të zgjedhur nga organet kushtetuese dhe parimeve të shtetit ligjor.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE

Projektligji nuk përafron legjislacionin e BE-së, ndaj nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit. Ndërkohë që parashikimet e përcjella përmes projektligjit, janë vlerësuar në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias të datës 22 Qershor 2006, nr. i dokumentit CDL-AD (2006)016.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 3 nene.

Në nenin 1 të projektligjit parashikohet organizimi i ceremonisë së betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes, emërimit ose shpalljes të emëruar të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, nga Presidenti i Republikës. Në përfundim të këtij afati, nëse anëtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është thirrur për të bërë betimin, është gjetur mekanizmi i paraqitjes së betimit në formë të shkruar dhe paraqitjen e tij te Presidenti i Republikës, pranë organit të emërtesës si dhe pranë Gjykatës Kushtetuese. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim, konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe përfshihet në dosjen e tij personale.

Në nenin 2 të projektligjit, parashikohet se pas pikës 4 të nenit 86 të ligjit, shtohet rregullimi ligjor i ri në pikën 5, i cili përcakton se gjyqtarët e zgjedhur, të emëruar ose të shpallur të emëruar, por që nuk kanë bërë betimin, me hyrjen në fuqi të këtij ligji betohen sipas rregullave të këtij ligji.

Në nenin 3 të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e tij ngarkohen të gjitha organet shtetërore, fusha e veprimtarisë shtetërore e të cilëve preket nga përmbajtja e tij.

VIII. HARTIMI I PROJEKT-AKTIT

Projektligji është nismë deputetësh.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk përcjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT

1. *Adnan Shkurti*
2. *Alkeid Hyseini*
3. *Edmond Lela*